UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS
Lënda: **MENAXHIMI I PROJEKTEVE**

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Menaxhimi i Projekteve
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III-të semestri V-të
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Ass.Dr. Fehmi Azemi
Detajet kontaktuese:	fehmi.azemi@uni-gjilan.net
Përshkrimi i lëndës	Menaxhimi i projektit është disiplina e definimit dhe menaxhimit lidhur me vizionin, detyrat, dhe burimet e nevojshme për të identifikuar, inicuar, monitoruar dhe përfunduar një projekt. Ky kurs ofron një hyrje në procesin e menaxhimit të projektit, menaxhimin e burimeve (koha , paratë dhe njerëzit), kontrollin e cilësisë, të komunikimit, dhe menaxhimin e riskut. Menaxhimi i Projekteve zhvillon njohuritë e studentëve dhe shërben si mjet për ekzekutimin e suksesshëm të projektit. Bazuar në IPMA dhe PMBOK ky kurs zhvillon njohuritë e studentëve për ekzekutimin e suksesshëm të projektit dhe menaxhimin e ndryshimit. Kjo do të përfshijë përdorimin e instrumenteve të caktuara për monitorimin dhe kontrollin, orarët, raportimin e progresit, menaxhimin e riskut, menaxhimin e cilësisë, kostos si dhe kontraktimit dhe prokurimit.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës Menaxhimi i Projekteve është që të ndërtoj një kornizë të njohurive të përgjithshme rreth menaxhimit të projekteve, rëndësisë që ka sot ne zhvillimin ekonomik global një gamë njohurishë nga kjo, dhe të arrihet që këto njohuri të mund të implementohën në jetën profesionale në të ardhmen. Si objektiv i lëndës është që studentët do të jenë në gjëndje të kuptojnë dhe të

	përdorin ecuritë e praktikave të mësuara nëpër të gjitha fazat e një projekti, të aplikojnë fushat e menaxhimit të projekteve, demonstrojnë kompetenca në menaxhimin e një plani të projektit, në veçanti
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi, studenti do të tregojë këto kompetenca: Kompetencë mbi nevojën për menaxhimin e projektit Aftësi për te përcaktuar se çfarë është një projekt dhe të shpjegojë varësinë midis fushave, dijës dhe grupeve të procesit Shpjegoj konceptet themelore të menaxhimit të projektit Grumbulloj kërkesat dhe të zhvilloj një plan për një projekt të thjeshtë Kompetenca për të menaxhuar, ndjekur dhe të raportoj statusin e një projekti të thjeshtë Analizuar rezultatin e një projekti të thjeshtë dhe të zhvillojnë mësimet e nxjerra Për të inicuar, fushëveprimin, dhe të planifikoj një projekt dhe të zhvillojnë një orar projekti Përcaktoj koston e projektit dhe të marrë burimet Kontrolloj ndryshimet e projektit dhe për të menaxhuar rrezikun e projektit Ekzekutojë dhe të mbyllë një projekt, si dhe - Të përdorë paketa softuerike te aplikimit për planin, qëllimin, dhe menaxhimin e projekteve

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	**Orë**	**Ditë/javë**	**Gjithsej**
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Kollokuiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	5	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	4	8	32
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	3	6
Projektet, prezantimet ,etj	3	1	3
Totali			**150**

Metodologjia e mësimdhënies:	Mësimdhënia do të zhvillohet përmes ligjëratës, shembujve praktikë, interpretimeve individuale e grupore, punimit të seminareve, vlerësimeve periodike, etj. Të gjitha këto do të realizohet në aspektin teorik dhe praktik duke i prezantuar materialet në formën audio-vizuale përmes teknologjisë elektronike me programet e Windows Office.

Metodat e vlerësimit:	Testi i parë: 40 pikë Testi i dytë: 40 pikë Detyrat e shtëpisë: 10 pikë (2 detyra x 5 pikë) Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 10 pikë Provimi përfundimtar: 80 pikë Totali: 100 pikë. Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90= 9; 91-100 = 10 Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese.
Literatura	
Literatura bazë:	1. Enver Kutllovci " Ligjeratat e pergatitura dhe projektet konkrete "Prishtinë, 2014 2. Suzana Panariti " Manaxhimi i projektit" Tiranë,2002Suzana Panariti " Manaxhimi i projektit" Tiranë 2010
Literatura shtesë:	1. Weiss and Wysocki "5-Phase project management" 2002 2. 1. Hurkens, Gary : Project Management,Mc Grow Hill 2002 USA 3. Dennis Lock : Project Management" 2002 4. ITAP " Hartimi dhe Menaxhimi i Projekteve" Tiranë 2003

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	**Ligjërata që do të zhvillohet**
Java e parë:	*Menaxhimi i Projekteve- Hyrje*
Java e dytë:	*Definimi dhe përkufikizimi i Projektit*
Java e tretë:	*Planifikimi i Projektit*
Java e katërt:	*Menaxheri i projektit*
Java e pestë:	*Format e organizimit të projektit*
Java e gjashtë:	*Ekipi i Projektit*
Java e shtatë:	*Planifikim dhe Skedulimi i Projektit*
Java e tetë:	***Testi I-re***
Java e nëntë:	*Analiza e diagrameve rrjet*
Java e dhjetë:	*Analiza e rrjetit me aktivitetet në nyje*
Java e njëmbëdhjetë:	*Monitorimi i projekteve*
Java e dymbëdhjetë:	*Kontrolli i projekteve*
Java e trembëdhjetë:	*Auditimi i projektit*
Java e katërmbëdhjetë:	*Përfundimi i Projektit dhe mësimet e nxjerra*
Java e pesëmbëdhjetë:	***Testi II-te***

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Politikat e mirësjelljes në pajtim me statutin e UKZ-së. **Neni 127** 1. **Studentët** që janë të pranuar në Universitet **kanë të drejtë**: 1.1. Të marrin pjesë në të gjitha ligjëratat, seminaret dhe në mësimet e organizuara në lëndët e programit të zgjedhur të studimit sipas mbarëvajtjes së studimeve; 1.2. Të shfrytëzojnë bibliotekat universitare dhe shërbimet tjera për studentë; 1.3. --------- 1.4. Studentët gëzojnë të drejtën për të paraqitur ide të reja dhe opinione të debatueshme pa rrezikuar humbjen e vendit të studentit ose privilegjet që mund të gëzojnë nga universiteti; 1.5. Studentët kanë të drejtë të ankohen lidhur me cilësinë e procesit të mësimdhënies ose për infrastrukturën e universitetit; 1.6. ------- **Neni 128** 1. **Studentët** që janë të pranuar në Universitet **kanë detyrim**: 1.1. T'i respektojnë rregulloret e lëshuara nga Universiteti; 1.2. T'i respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë; 1.3. T'u kushtojnë vëmendje të duhur studimeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike; 1.4. Të vijojnë ligjëratat në pajtim me rregullat e programit specifik të studimeve; 1.5. Të sillen mirë si në lokalet e Universitetit, ashtu edhe jashtë tyre për të mos e diskreditua Universitetin; 1.6. Të respektojnë rregullat e kodit etik;